



Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

**Komente në Projekt-Udhëzimin Administrativ (ME) Nr.Xx/2021 për
Kornizën e Përgjithshme të Raportimit për Eficiencë të Energjisë**

Komente të përgjithshme

Dokumenti i konsultimit nuk përmban kërkesat minimale të Rregullores Nr. 05/2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Ky dokument nuk përmban arsyetimin për hartimin e këtij Udhëzimi, gjendjen aktuale, problematikën kryesore që trajton, ndryshimet “nen-për-nen” që sjellë në legjislacionin e brendshëm dhe ndërlidhjen me direktivat dhe legjislacionin evropian.

Dokumenti i konsultimit nuk përmbush as kërkesat minimale të Rregullores për Standardet Minimale të Konsultimit Publik. Është një dokument pothuaj i zbrazët me asnjë shpjegim në lidhje me politikën që po ndiqet, cilat do të jenë ndryshimet nen-për-nen që do të ndodhin dhe problemet që synon t'i trajtoj dhe në përgjithësi impaktin që do të ketë. Adresimi i menjëhershëm i kësaj praktike të konsultave publike është i domosdoshëm. Kualiteti i dobët i dokumenteve të konsultimit po e dëmton dukshëm procesin e konsultimit në përgjithësi dhe po i vështirëson pjesëmarrjen e të gjithëve pa diskriminim në këtë proces.

Në përgjithësi, komentet e INDEP kanë të bëjnë me qartësimin dhe specifikimin e disa çështjeve. Në radhë të parë ne kemi kërkuar sqarime sa i takon periudhave të raportimit tek korniza e përgjithshme e raportimit, pastaj kemi kërkuar një ndarje të raportimit në fushën e transportit në bazë të llojit të karburantit, gjeneratorët me vet-konsum etj. Të gjitha këto, ne konsiderojmë që do ta pasuronin udhëzimin, do t'i jepnin kuptim më të qartë dhe do të kontribuonin në mbërritjen e objektivës së përbashkët për promovim të eficiencës dhe mbërritje të caqeve që do të vijnë.

Dokumenti ka edhe probleme gjuhësore dhe teknike por marrë në tërësi ne konsiderojmë që me disa ndryshime dhe përmirësime, është i nevojshëm të miratohet. Këto përmirësime ne i kemi shtjelluar në formë propozimesh në pjesën e komenteve specifike. Ky dokument dhe pjesëmarrja e INDEP në konsultimet publike është pjesë e programit të INDEP për qeverisje demokratike dhe punës së institutit në promovimin e reformës në administratë publike dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje. Përmbajtja specifike e kësaj konsulte kontribuon në realizimin e objektivave të programit për zhvillim të qëndrueshëm.

Komente specifike

Krahas komenteve të përgjithshme për Projekt-Udhëzimin Administrativ të Raportimit për Eficiencë të Energjisë, ne kemi shtuar edhe disa komente specifike të cilat sugjerojmë të adresohen në këtë dokument. Me anë të këtyre komenteve, ne synojmë që të përmirësojmë kushtet e raportimit dhe të ngrisin nivelin e transparencës. Komentet specifike kanë për qëllim ngirtjen e kualitetit të dokumentit në fjalë dhe adresimin e problemve që ne i shohim si të domosdoshme.

Komenti 1: Neni 4 – Korniza e përgjithshme për raporte vjetore, Pika 1.1. – Kërkojmë sqarime shtesë rreth termave të përdorur

1.1. Një vlerësim të treguesve në vijim në vitin para vitit të fundit (viti X (1) - 2):

Fjalja e lartpërmendur është e komplikuar dhe e pakjartë. Andaj thjeshtësimi i fjalisë do të bënte për të gjithë akterët më të kuptueshme dhe më të kjashtë domethënien e saj. Pra, përmes këtij komenti kërkojmë sqarime se për cilin vit në të vërtetë e ka fjalën organi i konsultës. Kjo do të sqaronte për qytetarët dhe akterët e involvuar në implementimin e kësaj dispozite.

Komenti 2: Neni 4 – Korniza e përgjithshme për raporte vjetore, Pika 1.2.2.2. – Të bëhet ndarja e transportit në bazë të lëndëve djegëse, të shtohet paragrafi 1.2.2.2.1. me këtë përmbajtje:

1.2.2.2.1. Transporti (të bëhet ndarja sipas shfrytëzimit të lëndëve djegëse)

Kjo ndarje paraqet të dhëna të cilat ndihmojnë në krahasimin e nivelit të ndotjes nga transporti. Ndarja e tillë dhe paraqitja e të dhënave krahasuese ndaj shfrytëzimit të lëndëve djegëse për transport, ndikojnë në kompletimin e Raporteve Vjetore.

Komenti 3: Neni 4 – Korniza e përgjithshme për raporte vjetore, Të shtohet pika për sasinë e liruar të gazrave serrë me këtë përmbajtje:

1.x. Sasia e emetuar e gazrave serrë

Kjo pikë është esenciale dhe e nevojshme për pjesëmarrje brenda raportit të monitorimit. Duke synuar dekarbonizmin dhe tranzicionin energjetik, matja e niveleve të emetimit nga gazrat serrë duhet të jetë parametër i paraqitur në secilin raport. Këto matje përpos pasurimit të raportit, ndikojnë në definimin e arritjes së caqeve energjetike dhe siguron progres në kompletimin e raportit përkatës.

Komenti 4: Neni 4 – Korniza e përgjithshme për raporte vjetore, Pika 1.3. – Të shtohet paragrafi 1.3.4.5. me këtë përmbajtje:

1.3.4.5. Prodhimi i energjisë elektrike nga gjeneratorët me vetë-konsum

Informatat e tilla janë të dobishme për arritjen e caqeve aktuale dhe përgaditjen e caqeve të reja sa i përket Eficiencës së Energjisë dhe gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të

ripërtrishme. Ne konsiderojmë që përfshirja e kësaj kategorie është e rëndësishme së veçantë dhe paraqet ngritje të kualitetit të raportimit. Shtimi i këtij paragrafi do të shënonte një progres në kornizën raportuese dhe në kualitetin e saj.

Komenti 5: Neni 6 – Mënyra e raportimit për raportet vjetore dhe progresin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, Të shtohet paragrafi sipas përmbajtjes në vazhdim:

Koha e raportimit për raportet vjetore dhe progresin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë bëhet në tre mujorin e parë të vitit pasues.

Raportimi në muajt e parë të vitit pasues përcakton mbarëvajtjen e pjesës së mbetur të vitit përkatës por edhe viteve pasuese. Njoftimi i hershëm me raportimin ndikon në afatizim më të thjeshtë dhe më të shpejtë të proceseve, lë hapësirë më të madhe për përmirësim në vitin kur bëhet raportimi si dhe ndikon në trajtim më të shpejtë në pikat të cilat janë më urgjente.

Komenti 6: Neni 6 – Mënyra e raportimit për raportet vjetore dhe progresin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, Mënyra e raportimit të bëhet përmes platformave publike, të shtohet paragrafi si në vijim:

2. Raportimet e bëra vendosen në platforma publike

Qytetarët dhe të gjithë akterët e tjerë duhet të jenë në dijeni për raportimet e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë. Kjo pasi që përmes raportimit të tillë mundësohet një proces transparent, më efikas dhe më i kontrollueshëm. Përmes platformave publike mund të ketë edhe komente, të cilat gjithsesi duhet të mirren parasysh dhe gjithashtu duhet t'u kthehet edhe përgjigje ankesave apo rekomandimeve të tyre. Metoda e tillë e raportimit do të siguronte që aspekti i energjisë e veçanërisht eficientia e energjisë të mos kalohej pa u trajtuar në mënyrë adekuate.